

Përmbledhje e seancave gjyqësore – E mërkurë 14 qershor 2023

- U zhvillua seanca gjyqësore ndaj të pandehurve:
 - 1. Selaudin Shahini**, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e kryer në bashkëpunim, me shumë se një herë, në formën e veçante të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 141/a, pg 2 dhe 28/4 i Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, në formën e krijimit, organizimit dhe drejtimit të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 333/a pg 1 i Kodit Penal dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334, pika 1 i Kodit Penal.
 - 2. Ndrçim Shahini**, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e kryer në bashkëpunim, me shumë se një herë, në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 141/a, pg 2 dhe 28/4 i Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, në formën e pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334, pika 1 i Kodit Penal.
 - 3. Ervis Cara**, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e kryer në bashkëpunim, me shumë se një herë, në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 141/a, pg 2 dhe 28/4 i Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, në formën e pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334, pika 1 i Kodit Penal.
 - 4. Endi Ahmetaj**, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e kryer në bashkëpunim, me shumë se një herë, në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 141/a, pg 2 dhe 28/4 i Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, në formën e pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334, pika 1 i Kodit Penal.
 - 5. Vojsava Doda**, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 141/a, pg 1 dhe 28/4 i Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, në formën e pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334, pika 1 i Kodit Penal.
 - 6. Aurel Shatri**, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 141/a, pg 1 dhe 28/4 i Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, në formën e pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334, pika 1 i Kodit Penal.
 - 7. Fatri Braha**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Gjykata, bazuar në nenet 112, 190, 375, 379, 380, 389, 380, 388 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 1/c, 28/4, 47-50, 55, 141/a, 248, 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal,

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Selaudin Shahini** për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i mjeteve motorike*”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 141/a, pg 2, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me **11 (njëmbëdhjetë) vite burgim.**
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Selaudin Shahini**, për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a, pg 1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimit e tij me **3 (tre) vite burgim.**
3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehur **Selaudin Shahini** dënohet me një dënim të vetëm prej **11 (njëmbëdhjetë) vite burgim.**
4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Selaudin Shahini** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **7 (shtatë) vite e 4 (katër) muaj burgim.**
5. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Selaudin Shahini** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
6. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ndriçim Shahini** për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i mjeteve motorike*”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 141/a, pg 2, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me **10 (dhjetë) vite burgim.**
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ndriçim Shahini**, për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a, pg 2 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimit e tij me **2 (dy) vite burgim.**
8. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehur **Ndriçim Shahini** dënohet me një dënim të vetëm prej **10 (dhjetë) vite burgim.**
9. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Ndriçim Shahini** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **6 (gjashtë) vite e 8 (tetë) muaj burgim.**
10. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Ndriçim Shahini** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
11. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervis Cara** për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i mjeteve motorike*”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 141/a, pg 2, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me **10 (dhjetë) vite burgim.**
12. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervis Cara**, për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a, pg 2 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimit e tij me **2 (dy) vite burgim.**

13. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehurit **Ervis Cara** dënohet me një dënim të vetëm prej **10 (dhjetë) vite burgim**.
14. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Ervis Cara** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **6 (gjashtë) vite e 8 (tetë) muaj burgim**.
15. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Ervis Cara** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
16. Deklarimin fajtores të të pandehurës **Vojsava Doda** për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i mjeteve motorike*”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 141/a, pg 1, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me **8 (tetë) vite burgim**.
17. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Vojsava Doda**, për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a, pg 2 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **2 (dy) vite burgim**.
18. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehurës **Vojsava Doda** dënohet me një dënim të vetëm prej **8 (tetë) vite burgim**.
19. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës **Vojsava Doda** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **5 (pesë) vite e 4 (katër) muaj burgim**.
20. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga e pandehura **Vojsava Doda** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
21. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Aurel Shatri**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Trafikimi i mjeteve motorike*”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 141/a, pg 1, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, pasi nuk provohet se e ka kryer veprën për të cilën akuzohet në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale.
22. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Aurel Shatri**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a, pg 2 i Kodit Penal, pasi nuk provohet se e ka kryer veprën për të cilën akuzohet në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale.
23. Bazuar në nenin 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, caktuar ndaj të pandehurit **Aurel Shatri** me vendimin nr. 14, datë 27.02.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
24. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit **Aurel Shatri** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
25. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Endi Ahmetaj** për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorim i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **5 (pesë) vite burgim**.
26. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Endi Ahmetaj**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a, pg 2 i

Kodit Penal, pasi nuk provohet se e ka kryer veprën për të cilën akuzohet në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale.

27. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Endi Ahmetaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **3 (tre) vite e 4 (katër) muaj burgim**.
28. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Endi Ahmetaj** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
29. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatri Braha** për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorim i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozitë dënimin e tij me **9 (nëntë) muaj burgim**.
30. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Fatri Braha** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **6 (gjashtë) muaj burgim**.
31. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Fatri Braha** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.